





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



GYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI

DEGA NË LIPJAN – OGRANAK LIPLJANE

Rexh.nr.4198/2012

GYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË LIPJAN, DEPARTAMENTI PËR KUNDËRVAJTJE, sipas gjyqtarit Rustem Begolli duke vendosur ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurës: Vlora Fatmir Limani per vepër kundrevajtëse te kryer nga neni 5.6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të ligjit nr.04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar , si dhe ne mbështetje te neneve 73,74 , 195 dhe te LMK, me daten 18.10.2013 bjen kete:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET PROCEDURA KUNDËRVAJTËSE ndaj të pandehurës Vlora Fatmir Limani në bazë të nenit 198.al.l.pk.8. të Ligjit mbi kundërvajtjet, me që nuk ka prova se e pandehura ka kryer veper te kundervajtjes nga neni 5.6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të ligjit nr.04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar.

Me nga një kopje të këtij aktvendimi do të njoftohet i pandehuri dhe paraqitësi i kërkeses.

A r s y e t i m

Agjencia per antikorupcion ka paraqitur kërkesen nr.01-2203/2012 me datën 04.06.2012, dhe ka kerkuar qe te zhvillohet procedura kundervajtese, kunder te pandehurës Vlora Fatmir Limani për veprën kundervajtëse si më lartë.

Kjo gjykatë me aktvendimin 4198/2012 të datës 07.06.2013 të pandehurën Vlora Fatmir Limani e ka shpallur përgjegjëse për veprën kundervajtëse si në dispozitiv të këtij aktvendimi dhe I ka shqiptuar denimin me gjobë në shumë prej 300 euro.

Gjykata e Apelit në Prishtinë-departamenti për kundervajtje duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e pandehura, ka nxjerë aktvendimin K.A.nr.804/2013 të datës 18.07.2013, ku me atë aktvendim e ka abroguar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Degës në Lipjan – Divizionit për Kundervajtje nr.4198/2012 të datës 07.06.2013 dhe qështjen e ka kthyer në plotësim dhe rivendosje.

Kjo gjykatë duke vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit në Prishtinë-divizionit për kundervajtje me qëllim të plotësimit të procedurës e ka ftuar parashtruesin e kërkesës-përfaqësuesin e agjencisë për antikorupcion-Enis Sadikun i cili në seancën e datës 14.10.2013 ka deklaruar: Dua të deklaroj se për të pandehurën Vlora Limani si Këshilltare Komunale po ashtu


antikorupcion. Për të pandehurën Vlora Limani është kërkuar që ta deklaroj pasurinë brenda intervalit kohor prej "01.mars e deri me 31 mars 2012", dhe mënyra e deklarimit ka qenë me kërkesë të agjenciont për antikorupcion. Ndërsa arsye për deklarimin me kerkese të agjencisë ka qenë për herë të parë këtë vitë, sepse përpara nuk kanë qenë të obliguar, ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit të ri me nenin 3 janë obliguar edhe Këshilltarët Komunal që të bëjnë deklarimin e pasurisë. Po ashtu dua të deklaroj se personat të cilit kanë qenë pika kontaktuse, me ta kemi mbajtur trajnime para marsit të vitit 2012, dhe të njejtit na kanë ofruar listat e zyrtarëve të lartë të cilit kanë pasur për obligim që të bëjnë deklarimin e pasurisë. Në rastin konkret në listën e personave të cilit kanë pasur për obligim që ta deklarojnë pasurinë ka qenë edhe e pandehura Vlora Limani. Në pytjen e gjyqtarit drejtuar perfaqësuesit të agjencisë për antikorupcion se a keni pasë informat se zyrtarja ka qenë e njoftuar apo jo , i njejt i u pergjegj negativisht.

Po ashtu kjo gjykatë e shqyrtoi perseri deklaratën e Sami Bytyqit të dhënë me datën 18.04.2013 në cilësi të deshmitarit i cili ka qenë personi kontaktues për informimin e asambleistëve në KK të Lipjanit lidhur me obligimin e deklarimit të pasurisë i cili ka deklaruar: Dua të deklaroj se është e vertet se kam qenë personi pergjegjës në Komunën e Lipjanit i cili kam pasur për obligim që të njoftoj personat të cilit kanë për obligim deklarimin e pasurisë pranë KK Lipjan për agjencinë e antikorupcionit. Dua të theksoj se njoftimin e deputetëve për obligimin e deklarimit të pasurisë **nuk e kam bërë unë**, por kam shkuar te kryesusi I kuvendit komunal I cili gojarishtë e ka marë përgjegjësinë që të bëjë njoftimit e deputetëve që ta bëjnë deklarimin e pasurisë me të cilin kam biseduar dhe I cili është I gatshëm që të vjen të jap deklaratë pranë kësaj gjykate.

Gjyqtari duke u bazuar ne shkresat e lendes, e sidomos ne deklaraten e perfaqësuesit të agjencisë për antikorupcion Enis Sadikut e posaqërishtë në deklaratën e deshmitarit Sami Bytyqi , ka vertetuar ne baze te bindjes se lire se ne veprimet e të pandehurës Vlora Limani nuk egzistojne elementet e vepres kundervajtese e cila i veket ne barre konfrome nenit neni 5.6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të ligjit nr.04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me qe nuk eshte vertetuar se e pandehura ka kryer veprën kundervajtëse për të cilën po ngarkohet, ndaj te cilit pezullohet procedura kundervajtese konforme nenit 198 alinea 1 pika 8 te LMK-se me qe nuk ka prova se e pandehura ka kryer veper te kundervajtjes.

Mbi të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kunder ketij aktvendimi mund te parashtrohet ankes Gjykates se apelit ne Prishtine divizionit per kundervajtje ne afat prej 8 dite nga dita e marrjes se te njejt, ne permes kesaj gjykate pa taksa.



Gjyqtari
Rrustem Begolli

R. Begolli